



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës

PROJEKTVENDIM

NR. _____, DATË ____ / ____ / 202__

PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN NR. 125, DATË 27.07.2023 TË KËSHILLIT BASHKIAK PËR MIRATIMIN PËR VËNIEN NË DISPOZICION TË PROJEKTIT, SIPAS VKM-SË NR. 17, DATË 18.01.2023, PËR ZHVILLIMIN E PRONËS ME NR. PASURIE 1/27, ZONA KADASTRALE 8513, E LLOJIT "SHESH", ME SIP.19367.4 M²; TË PRONËS ME NR. PASURIE 1/31, ZONA KADASTRALE 8513, E LLOJIT "TRUALL", ME SIP.609.42 M²; TË PRONËS ME NR. PASURIE 1/33, ZONA KADASTRALE 8513, E LLOJIT "SHESH", ME SIP. 2125.51 M²; TË PRONËS ME NR. PASURIE 1/168, ZONA KADASTRALE 8513, E LLOJIT "TRUALL", ME SIP. 7518.84 M²; TË PRONËS ME NR. PASURIE 1/162, ZONA KADASTRALE 8513, E LLOJIT "TERREN SPORTIV", ME SIP. 2946.04 M²; TË PRONËS ME NR. PASURIE 1/159, ZONA KADASTRALE 8513, E LLOJIT "TERREN SPORTIV", ME SIP. 7105.83 M²; TË PRONËS ME NR. PASURIE 1/34, ZONA KADASTRALE 8513, E LLOJIT "SHESH", ME SIP. 1703.31 M²; TË PRONËS ME NR. PASURIE 1/32, ZONA KADASTRALE 8513, E LLOJIT "TERREN SPORTIV", ME SIP. 24827.4 M²; NË PRONËSI TË BASHKISË Durrës DHE MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR ZHVILLIMIN E PROJEKTIT TË ZONËS MULTIFUNKSIONALE PËRRRETH KOMPLESIT TË STADIUMIT "NIKO DOVANA" NË Durrës, PËRFSHIRË STADIUMIN, E LIDHUR MIDIS MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT, BASHKISË Durrës, AGJENCISË SË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT (AKPT) DHE FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT (FSHZH)

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, ligjit nr. 102/2020 "Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin, ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, ligjit nr. 79/2017, "Për sportin", VKM-së nr. 17, datë 18.01.2023, "Për ngarkimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, si organ qendror blerës, për realizimin e konkursit të projektimit për projektidetë e rikonceptimit të komplekseve sportive të stadiumeve në qytetet e Durrësit, Korçës dhe Vlorës", VKM-së nr.536, datë 01.05.2008, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike të shtetit, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Durrës", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 345, datë 19.6.2025 Për transferimin të Korporatës së Investimeve Shqiptare të pronave shtetërore për realizimin e projektit të investimit "Rijetëzimi i stadiumit 'Niko Dovana', Durrës", si dhe në vijim të marrëveshjes së bashkëpunimit për zbatimin e projektit të investimit "Për zhvillimin dhe menaxhimin e pronës shtetërore, nënprojektit "Rijetëzimi i stadiumit Niko Dovana, Durrës" lidhur midis Korporatës së Investimeve Shqiptare, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, Federatës Shqiptare të Futbollit dhe Bashkisë Durrës", protokolluar me tonën nr.7852 prot datë 27.06.2025, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike dhe Drejtoria Arsimit, Kulturës, Sporteve, Rinisë dhe Komuniteteve Fetare, kryetari i bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Durrës të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe,

TË VENDOSË:

1. Miratimin e ndryshimit të pikës 2 (dy) të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 125, datë 27.07.2023, si më poshtë vijon:
2. Miratimin e nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit për zbatimin e projektit të investimit "Për zhvillimin dhe menaxhimin e pronës shtetërore, nënprojektit "Rijetëzimi i stadiumit Niko Dovana, Durrës" lidhur midis Korporatës së Investimeve Shqiptare, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, Federatës Shqiptare të Futbollit dhe Bashkisë Durrës" sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Miratimin e ndryshimit të pikës 3 (tre) të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 125, datë 27.07.2023, si më poshtë vijon:
3. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë apo personi i autorizuar prej Tij, për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit për zbatimin e projektit të investimit "Për zhvillimin dhe menaxhimin e pronës shtetërore, nënprojektit "Rijetëzimi i stadiumit Niko Dovana, Durrës" lidhur midis Korporatës së Investimeve Shqiptare, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, Federatës Shqiptare të Futbollit dhe Bashkisë Durrës".
3. Ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Vendore, Drejtoria Ligjore, Drejtoria Arsimit, Kulturës, Sporteve, Rinisë dhe Komuniteteve Fetare, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

PËR DREJTORINË E PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Drejtör
Robert Dervishi

DREJTORIA E ARSIMIT, KULTURËS, SPORTEVE, RINISË DHE KOMUNITETEVE FETARE

Drejtör
Adrian Gurra

PËR DREJTORINË E PROJEKTEVE DHE INFRASTRUKTURËS PUBLIKE

Drejtör
Loren Facja

PËR DREJTORINË LIGJORE

Drejtör
Alneida Rroshi

KRYETAR

Eniriana Sako



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës

RELACION

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TW VKB – SË NR.125 DATË 27.07.2023 “PËR MIRATIMIN PËR VËNIEN NË DISPOZICION TË PROJEKTIT, SIPAS VKM-SË NR. 17, DATË 18.01.2023, PËR ZHVILLIMIN E PRONËS ME NR. PASURIE 1/27, ZONA KADASTRALE 8513, E LLOJIT “SHESH”, ME SIP.19367.4 M2; TË PRONËS ME NR. PASURIE 1/31, ZONA KADASTRALE 8513, E LLOJIT “TRUALL”, ME SIP.609.42 M2; TË PRONËS ME NR. PASURIE 1/33, ZONA KADASTRALE 8513, E LLOJIT “SHESH”, ME SIP. 2125.51 M2; TË PRONËS ME NR. PASURIE 1/168, ZONA KADASTRALE 8513, E LLOJIT “TRUALL”, ME SIP. 7518.84 M2; TË PRONËS ME NR. PASURIE 1/162, ZONA KADASTRALE 8513, E LLOJIT “TERREN SPORTIV”, ME SIP. 2946.04 M2; TË PRONËS ME NR. PASURIE 1/159, ZONA KADASTRALE 8513, E LLOJIT “TERREN SPORTIV”, ME SIP. 7105.83 M2; TË PRONËS ME NR. PASURIE 1/34, ZONA KADASTRALE 8513, E LLOJIT “SHESH”, ME SIP. 1703.31 M2; TË PRONËS ME NR. PASURIE 1/32, ZONA KADASTRALE 8513, E LLOJIT “TERREN SPORTIV”, ME SIP. 24827.4 M2; NË PRONËSI TË BASHKISË Durrës DHE MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR ZHVILLIMIN E PROJEKTIT TË ZONËS MULTIFUNKSIONALE PËRRRETH KOMPLESIT TË STADIUMIT “NIKO DOVANA” NË Durrës, PËRFSHIRË STADIUMIN, E LIDHUR MIDIS MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT, BASHKISË Durrës, AGJENCISË SË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT (AKPT) DHE FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT (FSHZH)”

Në mbështetje të Ligiit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, VKM-ja nr.345 datë 19.06.2025 “Për transferimin të Korporatave të Investimeve Shqiptare të pronave shtetërore për realizimin e projektit të investimit “Rijetëzimi i stadiumit “Niko Dovana”, Durrës”, VKB-ja nr.125 datë 27.07.2023, si dhe në vijim të marrëveshjes së bashkëpunimit për zbatimin e projektit të investimit “Për zhvillimin dhe menaxhimin e pronës shtetërore, nënprojektit “Rijetëzimi i stadiumit Niko Dovana, Durrës” lidhur midis Korporatës së Investimeve Shqiptare, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, Federatës Shqiptare të Futbollit dhe Bashkisë Durrës”, protokolluar me tonën nr.7852 prot datë 27.06.2025,

Të nderuar këshilltarë,

Me Vendimin e Këshillit Bashkiak Durrës nr.125 datë 27.07.2023 “Për miratimin për vënie në dispozicion të projektit, sipas VKM-së nr. 17, datë 18.01.2023, për zhvillimin e pronës me nr. pasurie 1/27, zona kadastrale 8513, e llojit “shesh”, me sip.19367.4 m2; të pronës me nr. pasurie 1/31, zona kadastrale 8513, e llojit “truall”, me sip.609.42 m2; të pronës me nr.

pasurie 1/33, zona kadastrale 8513, e llojit "shesh", me sip. 2125.51 m²; të pronës me nr. pasurie 1/168, zona kadastrale 8513, e llojit "truall", me sip. 7518.84 m²; të pronës me nr. pasurie 1/162, zona kadastrale 8513, e llojit "teren sportiv", me sip. 2946.04 m²; të pronës me nr. pasurie 1/159, zona kadastrale 8513, e llojit "teren sportiv", me sip. 7105.83 m²; të pronës me nr. pasurie 1/34, zona kadastrale 8513, e llojit "shesh", me sip. 1703.31 m²; të pronës me nr. pasurie 1/32, zona kadastrale 8513, e llojit "teren sportiv", me sip. 24827.4 m²; në pronësi të Bashkisë Durrës dhe miratimin e marrëveshjes për zhvillimin e projektit të zonës multifunksionale përreth kompleksit të stadiumit "Niko Dovana" në Durrës, përfshirë stadiumin, e lidhur midis Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Bashkisë Durrës, Agjencisë së Planifikimit të Territorit (AKPT) dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit (fshzh)" është vendosur:

1. Miratimi për vënien në dispozicion të projektit, sipas VKM-së nr. 17, datë 18.01.2023, të pronës me nr. pasurie 1/27, Zona Kadastrale 8513, e llojit "shesh", me sip. 19367.4 m²; të pronës me nr. pasurie 1/31, Zona Kadastrale 8513, e llojit "truall", me sip. 609.42 m²; të pronës me nr. pasurie 1/33, Zona Kadastrale 8513, e llojit "shesh", me sip. 2125.51 m²; të pronës me nr. pasurie 1/168, Zona Kadastrale 8513, e llojit "truall", me sip. 7518.84 m²; të pronës me nr. pasurie 1/162, Zona Kadastrale 8513, e llojit "teren sportiv", me sip. 2946.04 m²; të pronës me nr. pasurie 1/159, Zona Kadastrale 8513, e llojit "teren sportiv", me sip. 7105.83 m²; të pronës me nr. pasurie 1/34, Zona Kadastrale 8513, e llojit "shesh", me sip. 1703.31 m²; të pronës me nr. pasurie 1/32, Zona Kadastrale 8513, e llojit "teren sportiv", me sip. 24827.4 m², në pronësi të Bashkisë Durrës, sipas certifikatës së pronësisë, lëshuar nga ASHK, Drejtoria Vendore Durrës.
2. Miratimi i marrëveshjes për zhvillimin e projektit të zonës multifunksionale përreth kompleksit të stadiumit "Niko Dovana" në Durrës, përfshirë stadiumin, e lidhur midis Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Bashkisë Durrës, Agjencisë së Planifikimit të Territorit (AKPT) dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë apo personi i autorizuar prej Tij, për nënshkrimin e Marrëveshjes midis Bashkisë Durrës, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Agjencisë së Planifikimit të Territorit (AKPT) dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH).
4. Pasuritë e përcaktuara në pikën 1 të këtij projektvendimi do të vihen në dispozicion të projektit me emërtimin : "Zhvillimi i zonës multifunksionale përreth kompleksit të stadiumit "Niko Dovana, në Durrës, përfshirë stadiumin", me kushtin, që pas përfundimit të projektit, pasuritë e sipërcituar dhe investimi që do të kryhet, të jenë në pronësi të Bashkisë Durrës.
5. Ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Vendore, Drejtoria Ligjore, Drejtoria Arsim, Kulturë, Komuniteteve Fetare, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Me shkresën nr.650 prot datë 17.02.2025, protokolluar me tonën nr.2504 prot datë 19.02.2025 "Dërgohet paketa finale për zhvillimin e zonës multifunksionale përreth Kompleksit të Stadiumit "Niko Dovana" në Durrës, përfshirë stadiumin", Fondi Shqiptar i Zhvillimit informon institucionin e Bashkisë Durrës se nuk do të financojë projektin "Zhvillimi i zonës

multifunkionale përreth Kompleksit të Stadiumit "Niko Dovana" në Durrës, përfshirë stadiumin", dhe gjithashtu përmes kësaj shkrese ka dërguar paketën finale të realizuar për këtë zhvillim.

Ndodhur në këto kushte për shkak të mungesës së financimit të këtij projekti nga ana e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, Bashkia Durrës i jemi drejtuar Koorporatës së Investimeve Shqiptare (AIC) me shkresën nr.2874 prot datë 26.02.2025 "Kërkesë për mbështetje financiare lidhur me zbatimin e realizimit të projektit të Zonës multifunkionale përreth kompleksit të Stadiumit "Niko Dovana" në Durrës, përfshirë edhe stadiumin.

Me shkresën nr.155/2 prot datë 09.04.2025, protokolluar me tonën nr.2874/1 prot datë 10.04.2025 "Në vijim të bashkëpunimit për zbatimin e projektit të investimit "Rijetëzimi i Stadiumit "Niko Dovana", Durrës", Koorporata e Investimeve Shqiptare ka shprehur gadishmërinë për zhvillimin e këtij projekti investimi.

Me shkresën nr.6386/1 prot datë 09.06.2025 Bashkia Durrës i është drejtuar Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, duke theksuar se e vlerëson këtë investim si tepër të rëndësishëm për qytetarët duke kërkuar gjithashtu që institucioni jonë dhe Këshilli Bashkiak Durrës të informohen mbi ecurinë e miratimit të Projektit të investimit "Rijetëzimi i stadiumit "Niko Dovan" Durrës".

Me shkresën nr.2897/1 prot, protokolluar me tonën nr.7620 prot datë 23.06.2025, Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr.345 datë 19.6.2025 "Për transferimin te Korporata e Investimeve Shqiptare të pronave shtetërore për realizimin e projektit të investimit "Rijetëzimi i stadiumit "Niko Dovana" Durrës", me anwn e tw cilit autorizon e shoqërinë aksionare "Korporata e Investimeve Shqiptare" vetë apo nëpërmjet entitetit të krijuar prej saj, për të vepruar si zhvillues i këtyre pronave dhe autorizimit të dhënë nga Këshilli Bashkiak Durrës nëpërmjet vendimit nr.125 datë 27.07.2023 në funksion të realizimit të projektit të investimit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi i cili ka si qëllim ndër të tjera, përmbushjen e interest publik, etj.

Përmes këtij relacioni ju bëjmë me dije se fillimisht nga ana e Këshillit Bashkiak Durrës me Vendimin nr.125 datë 27.07.2023 është dhënë miratimi për vënien në dispozicion të projektit të pasurive në pronësi të Bashkisë Durrës (pasuri të cilat përkojnë me shtojcën nr. 2 të VKM-së nr.345 datë 19.6.2025. Ndër të tjera me VKB-në nr.125 datë 27.07.2023 është vendosur miratimi i marrëveshjes për zhvillimin e projektit të zonës multifunkionale përreth kompleksit të stadiumit "Niko Dovana" në Durrës, përfshirë stadiumin, e lidhur midis Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Bashkisë Durrës, Agjencisë së Planifikimit të Territorit (AKPT) dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Referuar VKM-së nr.345 datë 19.06.2025, si dhe marrëveshjes së bashkëpunimit për zbatimin e projektit të investimit "Për zhvillimin dhe menaxhimin e pronës shtetërore, nënprojektit "Rijetëzimi i stadiumit Niko Dovana, Durrës" lidhur midis Korporatës së Investimeve Shqiptare, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, Federatës Shqiptare të Futbollit dhe Bashkisë Durrës" protokolluar me tonën nr.7852 prot datë 27.06.2025, kemi ndryshim vetëm të pikës 2 dhe 3 të VKB-së nr.125 datë 27.07.2023, pra nuk kemi asnjë ndryshim në pasuritë të cilat vihen në dispozicion për zhvillimin e projektit. Pra për sa më sipër kërkojmë ndryshimin e pikës 2, 3 të VKB-së nr.125 datë 19.06.2025 si më poshtë:

Ishte:

2. Miratimin e marrëveshjes për zhvillimin e projektit të zonës multifunkionale përrreth kompleksit të stadiumit "Niko Dovana" në Durrës, përfshirë stadiumin, e lidhur midis Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Bashkisë Durrës, Agjencisë së Planifikimit të Territorit (AKPT) dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë apo personi i autorizuar prej Tij, për nënshkrimin e Marrëveshjes midis Bashkisë Durrës, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Agjencisë së Planifikimit të Territorit (AKPT) dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH).

Bëhet:

2. Miratimin e nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit për zbatimin e projektit të investimit "Për zhvillimin dhe menaxhimin e pronës shtetërore, nënprojektit "Rijetëzimi i stadiumit Niko Dovana, Durrës" lidhur midis Korporatës së Investimeve Shqiptare, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, Federatës Shqiptare të Futbollit dhe Bashkisë Durrës" sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë apo personi i autorizuar prej Tij, për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit për zbatimin e projektit të investimit "Për zhvillimin dhe menaxhimin e pronës shtetërore, nënprojektit "Rijetëzimi i stadiumit Niko Dovana, Durrës" lidhur midis Korporatës së Investimeve Shqiptare, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, Federatës Shqiptare të Futbollit dhe Bashkisë Durrës".

PËR DREJTORINË E PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Robert Dervishi



PËR DREJTORINË E PROJEKTEVE DHE INFRASTRUKTURËS PUBLIKE

Lorenc Facja



PËR DREJTORINË E ARSIMIT, KULTURËS, SPORTEVE, RINISË DHE KOMUNITETEVE FETARE

Adrian Gurra

